

Të folurit me fëmijët rreth

# SHPREHIVE TË TË NGRËNIT





## SHPREHITË E TË NGRËNIT

Biri juaj Semi është 1 vjeç e gjysmë. Tash ai dëshiron të ushqehet vetë. Por, në vend se ta përdorë lugën dhe pirunin, Semi luan me ushqimin dhe nuk arrin ta fusë ushqimin në gojë. Ushqimi është kudo: në rrobat e tij, në flokë dhe në dysheme rreth tryezës. Ju zemëroheni, sepse mendoni për rrëmujën dhe për kohën që do t'ju duhet për ta pastruar kuzhinën.

Çdo prind është i mësuar me situata të tilla nga jeta e përditshme me të vegjlit. Si mund të reagojmë në mënyrë adekuate për të shmangur konfliktet dhe emocionet negative në situata të tilla?


*Në vazhdim, ju mund të analizoni situatën dhe reagimet tuaja me ndihmën e pyetjeve fillestare. Përveç kësaj, i gjeni disa këshilla për të reaguar si duhet.*

### Analizë



*A doni ta analizoni situatën? Ju lutemi, vazhdoni të lexoni në [faqen 2](#).*

### Këshilla



*A keni nevojë për këshillë të përgjithshme për të ngrënit me fëmijët e vegjël? Ju lutemi, vazhdoni [faqen 3](#).*

## Analizë



Gjeni një mënyrë konstruktive për ndërveprim të suksesshëm me të voglin tuaj, që ndërtohet mbi tri veprime. Cilat janë tri veprimet dhe çfarë përbën ky koncept? Ju lutemi shihni në [faqen 4](#) dhe pastaj kthehuni në këtë detyrë.

Këto pyetje mund t'ju ndihmojnë të gjeni mundësi të suksesshme ndërveprimi:

**Kyçuni:** Cila është situata për të voglin tuaj?

**Flisni më shumë:** Çfarë mund t'i thoni fëmijës suaj? Përshkruani karakteristikat e ushqimit. Përshkruani atë që po shihni se po bën fëmija juaj. Përshkruani ndjenjat tuaja dhe arsyen pse jeni të zemëruar.

**Ndiqni radhën:** Çfarë mund të bëjnë vetë fëmijët tuaj të vegjël? Çfarë mund të bëni pastaj së bashku?

Ju lutemi, shënioni mendimet dhe idetë tuaja se si mund të reagoni në mënyrë adekuate në këtë situatë. Pastaj krahasoni ato me sugjerimin e dhënë në faqen tjetër.

---



---



---



---



---



---



---



---



---



---



---


### **Ide për komunikim të bazuar në tri veprimet:**

**Kyçuni:** Shoh se po luan me ushqimin tënd. A nuk të pëlqen ajo që është në pjatën tënde? A nuk ke uri?

**Flisni më shumë:** Kur e hedh ushqimin tënd përreth në këtë mënyrë, mua më duhet të kaloj shumë kohë për ta pastruar kuzhinën. Le ta shohim pjatën tënde së bashku. Unë po shoh shumë ushqim të shijshëm këtu dhe gjithashtu mban erë shumë të mirë. A mund t'i marrësh erë? A mund të të ndihmoj të hash?

**Ndiqni radhën:** Çfarë lloj ushqimi do të doje të provosh tjetër? Karrotë? Mmmm, është e ëmbël! Le t'i prejmë karrotat në copa të vogla. Këtë mund ta bëjmë së bashku. Sa rrisa janë në pjatën tënde? Le t'i numërojmë së bashku! Do të doje të pish ujë ose çaj? Ti mund ta mbash gotën vetë. Çfarë do të provosh tjetër? Ti mund t'i nxjerrësh vetë bizelet nga tasi, nëse ta pëlqen.

### **Këshilla**



### **Këshillë e përgjithshme për të ngrënit me fëmijët e vegjël:**

Kini parasysh se fëmija juaj mund të jetë i lodhur dhe jo i uritur. Në këtë moshë, fëmijët nuk janë të vetëdijshëm për nevojat dhe dëshirat e tyre. Ata gjithashtu nuk janë në gjendje t'i komunikojnë ato. Kështu, fëmija juaj vetëm mund të dojë të shprehet: Unë nuk jam i uritur, por jam shumë i interesuar për vendin përreth. Oh, gjëra shumë interesante këtu! Dhe çfarë mund të bëj me to!

Prandaj, mos i merrni personalisht veprimet e foshnjës suaj: Ai nuk dëshiron qëllimisht t'ju shkaktojë më shumë punë.

Nëse besoni se nuk mund të përballeni më me sjelljen e fëmijës, dilni nga situata. Mos luftoni për të ngrënit: Nëse fëmija juaj nuk dëshiron të hajë tani, ndoshta dëshiron të hajë më vonë. Largojeni pjatën dhe tregoni atij se do të provoni përsëri më vonë kur ai do të jetë i uritur.

Dijeni gjithmonë se sjellja e fëmijës suaj kurrë nuk bëhet për t'ju ngacmuar juve. Pra, mos u zemëroni. Mundohuni të qëndroni të qetë.

## **Çfarë duhet të di lidhur me komunikimin me bebet dhe fëmijët e vegjël?**

Të gjitha llojet e komunikimeve ndikojnë në trurin e një fëmije dhe gjuha është thelbësore për zhvillim të mirë të trurit të fëmijës suaj. Mungesa e komunikimit në fëmijërinë e hershme çon në zhvillimin e dobët të fjalorit, me pasoja negative për inteligjencën e fëmijës dhe suksesin e të mësuarit për tërë jetën. Truri ynë krijon një rrjet të neuroneve, duke përdorur të gjitha informatat e reja që vijnë nga rrethi. Përmes veprimeve shoqërore siç është komunikimi verbal dhe joverbal, përsëritja dhe thëllimi i stimujve, ne ndihmojmë trurin tonë për të forcuar dhe rritur këtë rrjet të paçmueshëm.

Kështu, si prindër, ju keni ndikim të madh mbi inteligjencën e fëmijës suaj dhe zhvillimin social e individual.

Si mund t'i jepni shtysë më së miri zhvillimit të trurit të fëmijës suaj?

Është shumë e rëndësishme të komunikoni në çdo rast me fëmijën tuaj, madje edhe në një fazë të hershme të fëmijërisë. Megjithatë, për zhvillimin e trurit të fëmijës nuk është e rëndësishme vetëm sa shpesh flisni, por edhe se si ju komunikoni me fëmijën e vogël. Shkencëtarët kanë dhënë disa sugjerime themelore (tri veprimet) për ju, që t'i keni parasysh.

### **Tri veprimet:**

**Kyçuni:** Kjo do të thotë se ju duhet ta vini veten në pozitën e të voglit. Vëzhgoni fëmijën tuaj. Për çfarë është i interesuar ai për momentin? Në çfarë fokusohet? Bisedoni me të voglin tuaj rreth këtyre gjërave (p.sh. kunjat, gotat ose tasat, tekstili, gurët, pasqyrat, kafshët, fëmijët e tjerë, emocionet ose vëzhgimet) edhe nëse ai nuk është në gjendje t'i kuptojë ende fjalët tuaja. Ndonjëherë fëmijët e vegjël do të ndryshojnë fokusin e tyre shumë shpejt. Ndodh që pas një minute libri mund të mos jetë më interesant për fëmijën, por ai mund të tregojë papritmas interes të madh në bllloqet lodra që janë në anën tjetër të dhomës. Lërimi fëmijët tuaj të shkojnë pas tyre dhe bëni komente për veprimet e tyre! Pranimi i perspektivës së një fëmije dhe bërja e komenteve për të e mbështet të mësuarit e fëmijës dhe zhvillimin e trurit. Fëmija nuk duhet të shpenzojë energji me gjëra jointerresante, të imponuara nga prindërit.

**Flisni më shumë:** Këtë këshillë është me të vërtetë lehtë për ta integruar në jetën tuaj të përditshme me të vegjlit. Komentoni të gjitha veprimet tuaja me fëmijën: ushqyerjen, ndërrimin e pelenave, veshjen, larjen. Fëmija juaj do të mbajë mend tingujt e ndryshëm të gjuhës suaj dhe pas një kohe do t'i riprodhojë ata. Shembuj:

- Shpjegoni objektin që fëmija juaj mban në duart e tij: Çfarë është kjo? Për çfarë e përdorim?
- Bashkërisht, kërkoni objekte tjera të ngjashme: Ku mund të gjejmë të tjera? Ku janë fshehur?
- Bëni pyetje: Kur fëmija juaj zgjat krahët për ju, pyetni së pari: "A dëshiron të vish këtu tek unë?" Dhe pastaj veproni duke e marrë fëmijën tuaj. Në këtë mënyrë fëmija juaj mund të krijojë lidhjen midis fjalisë dhe veprimit.

Kur i vogli juaj fillon të flasë fjalë (si "top"), zgjeroni fjalët e tij të shprehura në një fjali të plotë si: "Po, është një top" ose "A do të luash me topin?" Duke vepruar kështu, ose duke përdorur fjalët në një kontekst tjetër, ju e nxisni fëmijën tuaj për të komunikuar. Kjo gjithashtu e krijon dëshirën për ta përdorur gjuhën.

**Ndiqni radhën:** Derisa komunikoni me fëmijën tuaj, sigurohuni që të lejoni reciprocitet. Lejoni që fëmija t'i gjejë fjalët vetë, mos i parashikoni ato dhe t'i thoni ju paraprakisht. Të vegjëlve u duhet ca kohë për të gjetur fjalët e duhura në fazën e hershme të të mësuarit të gjuhës.

Përdorni pyetje të hapura, si: pse, kush, si? Fëmijëve u duhet të përdorin më shumë fjalë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, kështu që e ushtrojnë fjalorin e tyre me çdo përgjigje. Për më tepër, këto pyetje mbështesin komunikimin e vazhdueshëm. Kështu, biseda juaj nuk do të përfundojë pas pyetjes me një përgjigje njëfjalëshe: «po-jo».

**“Të folurit me fëmijët rreth shprehive të të ngrënit” është bazuar në referencat më poshtë:**

Nolan, Virginia. 2016. «Die Macht der Sprache.» *Das Schweizer Elternmagazin Fritz und Fränzi*, Oktober, 58-64.

Suskind, Dana, Beth Suskind und Leslie Lewinter-Suskind. 2015. *Thirty Million Words. Building a Child's Brain*. New York: Dutton.